



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

DFREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE SJIP-A

Nr.1089 Prot

Tiranë, më 04/12/2023

URDHËR

Nr. 126, Datë 04/12/2023

**MBI PROCEDURAT E KONKURIMIT, PËR PUNONJËS MËSIMORË  
“LEKTOR/ ASISTENT LEKTOR” NË PROG.STUD. FIZARMONIKË,  
NË NJËSINË BAZË INTERPRETIM, PRANË FAKULTETIT TË  
MUZIKËS NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Mbështetur në Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë” Kreu IV “Personeli i Institucioneve të Arsimit të Lartë”, Neni 64, në Statutin e Universitetit të Arteve, të konkursit shpallur në Buletinin e Njoftimeve Publike me nr. 93, të datës 13/11/2023, për konkursin shpallur nga Rektorati i Universitetit të Arteve, për punonjës mësimorë nga kategoria “Lektor/ As.Lektor”, duke patur në konsideratë faktin se marrja në punë e personelit akademik në institucionet e AL kryhet me konkurim publik, mbi bazën e shpalljes së vendeve të lira dhe përcaktimit të kritereve për çdo vend pune, plotësimi i të cilave përbën kushtin themelor për konkurimin e kandidatëve dhe punësimin e tyre si punonjës mësimor, vlerësimi i dosjeve të kandidatëve konkurues do të kryhen nga Komisioni Ad Hoc i Vlerësimit të Kandidaturave (KVK), ngritur posaçërisht për këtë qëllim,

**URDHËROJ:**

1. Komisioni Ad-Hoc i vlerësimit të kandidaturave që konkurrojnë për punonjës mësimorë në Fakultetin e Muzikës, për pozicionin e punës “Lektor/Asistent Lektor”, në Programin e Studimit **Fizarmonike speciale dhe Muzikë Dhome**, ngrihet me Urdhër të Dekanit dhe përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë;
2. Për ngritjen e komisionit, Dekani vepron në këtë mënyrë:
  - a. Përzgjedh ndër personelin akademik të Njesisë Bazë përkatëse me dije në fushën për të cilën zhvillohet konkursi 4 (katër) anëtarë;
  - b. Emëron për anëtarë Komisioni, për konkursin e shpallur në, Buletinin e Njoftimeve Publike, për pozicionin “Lektor/Asistent lektor” në Fakultetin e Muzikës, 1 (një) anëtarë përfaqësues të Rektoratit, (Dr. Menaxhimit të Burimeve Njerëzore), të caktuar nga Rektori.
3. Komisioni ad hoc organizon, drejton dhe mbikqyr procedurat e zhvillimit të konkurimit, shqyrton dosjet dhe vlerëson me pikë kandidaturat e paraqitura mbi bazën e kritereve të





përgjithshme dhe të veçanta për këtë specialitet të publikuara dhe të shpallura publikisht nga Rektorati i Universitetit të Arteve.

Kryetari dhe anëtarët e Komisionit ad hoc janë përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit, duke filluar që nga marrja në dorëzim e dosjeve të kandidaturave, zhvillimin e konkurrimit deri në shpalljen e vendimit për vlerësimin, renditjen dhe përzgjedhjen e kandidaturave;

4. Komisioni ad hoc, duhet të përfundojë procedurat e konkurrimit të përcaktuar në urdhër, brenda 10 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e këtij urdhëri;
5. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ndihmon Komisionin ad hoc, mbikqyr dhe kontrollon zhvillimin e procedurave të konkurrimit në përputhje me aktet e zbatueshme, si dhe njofton periodikisht Rektorin, për ecurinë e tyre. Në rastet kur vërehen shkelje, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore njofton menjëherë Rektorin, i cili mund të vendosë pezullimin e procedurave. Në përfundim të konkurrimit, DMBNJ i paraqet Rektorit një raport me shkrim mbi zhvillimin e procedurave të konkurrimit;
6. Çdo anëtarë i Komisioni ad hoc është i detyruar të shqyrtojë në mënyrë individuale të gjitha dosjet e prezantuara për konkurrim. Komisioni ad hoc bën vlerësimin e dosjeve duke përcaktuar pikët e fituara për çdo dosje;
7. Menjëherë pas përfundimit të vlerësimit të fazave të konkurrimit, Komisioni ad hoc bën mbledhjen e pikëve të fituara për secilin kandidat si dhe përcakton renditjen përfundimtare të kandidatëve sipas pikëve të fituara. Komisioni ad hoc, bën klasifikimin e konkurrentëve, të cilët kanë marrë mbi 60% të pikëve totale (vendosur nga Komisioni ad hoc). Kandidatët me më pak se 60% të pikëve konsiderohen të skualifikuar;
8. Vendimet e Komisionit ad hoc merren me shumicë votash. Anëtarët nuk lejohet të abstenojnë;
9. Renditja përfundimtare e kandidatëve shpallet publikisht nga Komisioni ad hoc;
10. Dekani i Fakultetit të Muzikës i paraqet Rektorit listën e kandidatëve sipas renditjes së pikëve të fituara. Rektori lidh Kontratën e Punës me kandidatin e përzgjedhur;
11. Kandidatët mund të ankohen tek Rektori për renditjen e pikëve shpallur nga Komisioni ad hoc, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e kësaj liste. Në këtë rast si dhe në rastet kur Rektori e çmon të nevojshëm verifikimin e procedurave të konkurrimit, dosja e plotë e konkursit i paraqitet menjëherë Rektorit nga Dekani i Fakultetit.
12. Në rastet e përcaktuara më lart, Rektori shqyrton dosjen e konkurimit dhe vendos sipas rastit:

- a. Të mos pranojë ankimin;





- b. Të kthejë dosjen e konkursit për rivlerësim;
- c. Të anulojë konkursin.

13. Ngakohet Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Dekani dhe Komisioni ad hoc, për zbatimin e këtij urdhëri. Ky urdhër shpallet në mjediset e Fakultetit dhe u bëhet i njohur kandidatëve para fillimit të konkursit;

14. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**Prof. Kastriot ÇAUSHI**

**REKTOR  
UNIVERSITETI I ARTEVE**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

DFREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE SJIP-A

Nr. 1098 Prot

Tiranë, më 04/12/2023

**URDHËR**

Nr. 126/1, Datë 29/06/2021

**MBI PROÇEDURAT E KONKURIMIT, PËR PUNONJËS MËSIMORË  
“LEKTOR/ ASISTENT LEKTOR” NË PROG.STUD. FIZARMONIKË,  
NË NJËSINË BAZË INTERPRETIM, PRANË FAKULTETIT TË  
MUZIKËS NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Mbështetur në Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë” Kreu IV “Personeli i Institucioneve të Arsimit të Lartë“, Neni 64, në Statutin e Universitetit të Arteve, i ndryshuar, Neni 39 dhe 100, Urdhëri nr. 122, datë 04/12/2023 “Mbi procedurat e konkurrimit për punonjës mësimorë në Fakultetin e Muzikës, për pozicionin e punës kategoria “Lektor/Asistent Lektor”, në Prog.Studimit; **Fizarmonike speciale dhe Muzikë Dhome** në UART”, pika 2/b në cilësinë e titullarit të Institucionit,

**URDHËROJ:**

1. Msc. Elia PLAKU, caktohet anëtarë i Komisionit ad hoc për konkursin punonjës mësimorë në Fakultetin e Muzikës, për pozicionin e punës “Lektor/Asistent Lektor”;
2. Ky urdhër u bëhet i njohur personave të përcaktuar në pikat 1 më sipër;
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**Prof. Kastriot ÇAUSHI**

**REKTOR**

**UNIVERSITETI I ARTEVE**